



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 22 prill 2026

Z. Alban Hyseni, kryetar i Komunës
Komuna Gjilanit
Rr. "Isa Boletini", nr. 102
60 000 Gjilan

LETËR REKOMANDIMI

R. nr.1267/2025

I nderuar z. Hyseni,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 shtator 2025, pranoi ankesën e z. Bekim Zeqiri (në vijim: ankuesi), të parashtruar kundër Komunës së Gjilanit, përkatësisht kundër Drejtorisë Komunale për Arsim (në vijim: DKA), për shkak të dëmtimit të rrethojave metalike të fushës së sportit në Shkollën Fillore të Mesme të Ultë (ShFMU) "Dëshmorët e Kombit" në fshatin Livoq i Ulët të Komunës së Gjilanit.

Sipas pohimeve të ankuesit, i cili është edhe baba i dy fëmijëve që vijnë në mësimet në këtë shkollë, në fushën sportive ku nxënësit zhvillojnë aktivitetet e tyre, u dëmtuan rrethojat metalike, gjë që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e nxënësve.

Në procedurën hetimore sipas ankesës, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, më 19 shtator 2025, kontaktoi zyrtarin përgjegjës për informim në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, i cili pohoi se DKA-ja së shpejti do ta zgjidhë problemin.

Më 19 shtator 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi drejtorin e ShFMU-së "Dëshmorët e Kombit", i cili njoftoi se parashtroi në DKA një kërkesë për rregullimin e rrethojave të dëmtuara metalike në fushën e sportit dhe se, më 18 shtator 2025, zyrtarët nga Drejtoria për Shërbime Publike vizituan shkollën. Gjatë kësaj vizite, ata konstatuan se rrethojat e fushës paraqesin rrezik për nxënësit dhe se për këtë arsye do ta njoftojnë drejtorin e DKA-së.

Më 22 shtator 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit sërish kontaktoi drejtorin e shkollës, i cili njoftoi se inspektori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim vizitoi shkollën, gjatë së cilës vëzhgoi fushën e sportit dhe bëri disa fotografi.

Më 22 shtator 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi drejtorin e DKA-së, i cili njoftoi se po ndërmerr veprime për zgjidhjen e problemit dhe se rasti do të zgjidhet gjatë asaj jave.

Më 8 tetor 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit bisedoi me zyrtarin përgjegjës në Drejtorinë për Shërbime Publike, i cili njoftoi se, më 22 shtator 2025, inspektori i Drejtorisë

09 dhe i rekomandoi Drejtorisë për Shërbime Publike: *“1.Ndërhyrja e menjëhershme për riparimin ose zëvendësimin e rrethojës së dëmtuar. 2. Deri në përfundimin e punimeve, kufizimi i aktiviteteve sportive në këtë fushë për të shmangur rrezikun ndaj sigurisë së nxënësve dh stafit mësimor.”*

Më 16 janar 2026, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi ushtruesin e detyrës së drejtorit të DKA-së dhe biseduan për gjendjen e fushës së sportit në shkollë, i cili pohoi se problemi i rrethojës së fushës së sportit do të zgjidhet.

Më 23 janar 2026, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit sërish kontaktoi drejtorin e shkollës, i cili njoftoi se Komuna e Gjilanit ende nuk ndërmoi asnjë veprim për riparimin e rrethojës së dëmtuar të fushës së sportit.

Duke u bazuar në të lartcekurat, Avokati i Popullit vëren se kemi të bëjmë me një ambient shkollor i cili përbën rrezik ndaj sigurisë fizike të nxënësve.

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se secili qytetar gëzon të drejtën për jetën (neni 25, paragrafi 1). Po ashtu, garantohet se fëmijët gëzojnë të drejtën për mbrojtjen dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e tyre (neni 50, paragrafi 1), si dhe të drejtën e shkollimit të detyrueshëm pa pagesë, të financuar nga fondet publike (neni 47, paragrafi 1).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila është pjesë përbërëse e Kushtetutës së vendit, në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”* Gjithashtu, sipas Konventës, përcaktohet se shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë [...] (neni 24).

Edhe Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka për qëllim, pos të tjerash: *“Garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik.”*

Për më tepër, ky ligj përcakton se të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo nga kujdestari, nga institucionet, nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, nga gjykatat, nga autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (në vijim: LAP) në Republikën e Kosovës, neni 3, paragrafi 8, përcakton: *“Ministria, komuna, institucionet arsimore ...dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësisë së tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit [...]”*

Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 3, të LAP-it, përcaktohet se komunat kanë përgjegjësi shtesë për: ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore, sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjienike sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin, duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe të sigurisë efektive.

Sipas Raportit nr. 11-44-09 të inspektorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunës së Gjilanit, të datës 22 shtator 2025, autoritetet përgjegjëse duhet të gjejnë një zgjidhje për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e fëmijëve dhe të personelit të shkollës. Kjo përfshin garantimin e një ambienti të sigurt për nxënësit gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive në fushën e sportit, si dhe sigurimin e përkujdesjes efektive për fëmijët, për shëndetin dhe mirëqenien e të cilëve ekziston rreziku.

Rregullimet e lartcekura ligjore, përbëjnë detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur jetën e fëmijëve dhe mbrojtjen e integritetit fizik të tyre.

Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në rast *Iliya Petrov kundër Bullgarisë* (Aktgjykim i 24 korrikut 2021), rast ky që kishte të bënte me një lëndim serioz të një djalë 12 vjeçar në nënstacion elektrik, kishte trajtuar lëndimin e fëmijës në kuadër të drejtës për jetë. Lëndimi u shkaktua nga një nënstacion i cili ishte i pozicionuar në një park të hapur, ku fëmijët rrinin shpesh për të luajtur. Këtu GJEDNJ theksoi se shteti ka detyrimin të vendosë rregullore të përshtatshme, duke përfshirë një sistem për të kontrolluar zbatimin e duhur të rregullave të sigurisë. GJEDNJ vendosi që dështimi i shtetit për të siguruar që nënstacioni i energjisë elektrike të ishte i sigurt, megjithëse ishte në dijeni të problemeve të sigurisë, përbënte shkelje të së drejtës për jetë

Sa i përket çështjes së sigurisë në shkolla, Avokati i Popullit edhe pse në prizmin e dhunës në shkolla në rastin e tij ex officio nr. 661/2024 Përgjegjësia e institucioneve në raport me dhunën në shkolla, duke cituar standardet e GJEDNJ kishte theksuar mes tjerash, standardin e përcaktuar në rastin *Biba kundër Shqipërisë* (Aktgjykim i 7 majit 2024) ku GJEDNJ kishte theksuar:

72. Në çështjen në fjalë, nuk kontestohet fakti që ngjarja në fjalë ka ndodhur në ambientet e shkollës gjatë orarit të rregullt të shkollës dhe që autori, i cili ka kryer veprime me rrezikshmëri të lartë, ka qenë nxënës i asaj shkolle. Pritet që institucionet arsimore të marrin masat e duhura për të parandaluar përdorimin e objekteve të rrezikshme nga nxënësit në ambientet e shkollës ose në mbikëqyrje. Gjuajtja e një objekti të fortë me shirit llastiku ndaj një nxënësi tjetër është potencialisht e rrezikshme dhe mund të çojë në dëmtime serioze, siç ndodhi në këtë rast.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se mbrojtja e integritetit fizik të nxënësve dhe mbrojtja e jetës së tyre është detyrim pozitiv i të gjitha institucioneve shtetërore, shtuar këtu faktin dhe cenueshmërinë e fëmijëve për shkak të moshës dhe obligimin që çdo veprim i institucioneve të shtetit të merret në interesin më të mirë të tyre. Avokati i Popullit rrjedhimisht vlerëson se mos-rregullimi i rrethojës së dëmtuar mund të paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe të personelit të shkollës. Prandaj, institucionet përgjegjëse duhet ta trajtojnë këtë çështje me prioritet. Vonesat në gjetjen e një zgjidhjeje janë në kundërshtim me frymën e dispozitave të lartcekura, të cilat garantojnë të drejtat e fëmijëve dhe përcaktojnë detyrimet e shtetit për t'i ofruar dhe mbrojtur ato.

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan:

- *Pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për garantimin e një ambienti të sigurt për nxënësit gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive në fushën e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (ShFMU) "Dëshmorët e Kombit" në fshatin Livoq i Ulët të Komunës së Gjilanit.*

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.") dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

